



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS
SPECIJALIZOVANA VEÇA KOSOVA

Numri i lëndës: KSC-BC-2020-06

**Prokurorja e Specializuar k. Hashim Thaçit, Kadri Veselit,
Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit**

Vendosi: Trupi Gjykses II

Gjykatës Çarls L. Smith III, Kryegjykatës

Gjykatës Kristof Barte

Gjykatës Ginel Metro

Gjykatës Fergal Gejnor, gjykatës rezervë

Administratore: Fidelma Donlon

Data: 21 gusht 2024

Gjuha: Anglishte

Klasifikimi: Publik

**Vendim mbi Mocionin e Dytë të Prokurorisë për Konstatim Gjyqësor të Fakteve të
Shqyrtuara në Procese të Tjera**

Prokurores së Specializuar

Kimberli P. Uest

Mbrojtjes së Hashim Thaçit

Luka Mishetiç

Mbrojtësit të Viktimave

Sajmon Loz

Mbrojtjes së Kadri Veselit

Ben Emerson

Mbrojtjes së Rexhep Selimit

Xhefri Roberts

Mbrojtjes së Jakup Krasniqit

Venkatesvari Alagendra

TRUPI GJYKUES II ("Trupi Gjykues"), në bazë të neneve 3(2)(d) dhe (3), 12, dhe 21 të Ligjit Nr. 05/L-053 për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar ("Ligji") dhe rregullave 95(5), 104(1)(b), 138, dhe 157(2) të Rregullores së Procedurës dhe të Provave para Dhomave të Specializuara të Kosovës ("Rregullorja"), lëshon këtë vendim.

I. HISTORIKU PROCEDURAL

1. Më 16 dhjetor 2022, Trupi Gjykues shpalli aktgjykimin në çështjen gjyqësore kundër z. Salih Mustafa ("Aktgjykimi *Mustafa*").¹
2. Më 14 dhjetor 2023, Paneli i Gjykatës së Apelit shpalli aktgjykimin në të njëjtën çështje.²
3. Më 17 dhe 18 maj 2024, Trupi Gjykues lëshoi dy vendime për konstatim gjyqësor të fakteve të shqyrtuara në procese të tjera.³
4. Më 7 qershor 2024, Zyra e Prokurorit të Specializuar ("ZPS") dorëzoi mocionin e dytë për konstatim gjyqësor të fakteve të shqyrtuara në procese të tjera ("Mocioni").⁴

¹ KSC-BC-2020-05, F00494, Trupi Gjykues I, *Aktgjykim* ("Aktgjykimi *Mustafa*"), 16 dhjetor 2022, konfidencial (versioni me redaktime të mëtejshme i versionit të korigjuar të versionit të redaktuar publik u dorëzua më 24 janar 2024, F00494/RED3/COR).

² KSC-CA-2023-02, F00038, Paneli i Gjykatës së Apelit, *Aktgjykimi i Apelit* ("Aktgjykimi i Apelit *Mustafa*"), 14 dhjetor 2023, konfidencial (versioni i redaktuar publik u dorëzua po të njëjtën ditë, F00038/RED).

³ F01534, Trupi Gjykues, *Vendim mbi Mocionin e Prokurorisë për Konstatim Gjyqësor të Fakteve të Shqyrtuara në Procese të Tjera* ("Vendimi mbi Mocionin e Prokurorisë në lidhje me Faktet e Shqyrtuara"), 17 maj 2023, me Shtojcën 1, konfidenciale, dhe Shtojcën 2, publike; F01536, Trupi Gjykues, *Vendim mbi Mocionin e Mbrojtjes për Konstatim Gjyqësor të Fakteve të Shqyrtuara në Procese të Tjera* ("Vendimi mbi Mocionin e Mbrojtjes në lidhje me Faktet e Shqyrtuara"), 18 maj 2023, me Shtojcën 1.

⁴ F02365, Prokurorja e Specializuar, *Mocion i Dytë i Prokurorisë për Konstatim Gjyqësor të Fakteve të Shqyrtuara në Procese të Tjera*, konfidencial, 7 qershor 2024, me Shtojcën 1, konfidenciale (versionet e redaktuara publike të Mocionit dhe Shtojcës 1 të Mocionit u dorëzuan më 10 qershor 2024, F02365/RED dhe F02365/A01/RED).

5. Më 1 korrik 2024, pas miratimit të shtyrjes së afatit,⁵ katër ekipet e Mbrojtjes (bashkërisht, "Mbrojtja"), iu përgjigjën Mocionit të ZPS-së ("Përgjigjja").⁶

6. Më 8 korrik 2024, ZPS-ja iu kundërpërgjigj Përgjigjes ("Kundërpërgjigjja").⁷

II. PARASHTRIME

7. ZPS-ja kërkon që Trupi Gjyqësor të bëjë konstatim gjyqësor të 172 fakteve të shqyrtuara në çështjen *Mustafa* para Dhomave të Specializuara të Kosovës ("faktet e shqyrtuara e të propozuara")⁸ të cilat, parashtron ajo, janë relevante për këtë çështje.⁹ ZPS-ja parashtron se faktet e shqyrtuara e të propozuara : (i) kanë lidhje me pika që kontestohen në procesin aktual;¹⁰ (ii) nuk kanë lidhje me veprimet dhe sjelljen e të akuzuarve që përmenden si akuza në Aktakuzën e Konfirmuar;¹¹ (iii) janë të dallueshme, konkrete dhe të evidentueshme;¹² (iv) nuk ndryshojnë në mënyrë thelbësore nga formulimi i Aktgjykimit *Mustafa*;¹³ (v) nuk janë të paqarta ose çorientuese në kontekstin në të cilin janë parashtruar në Mocion;¹⁴ (vi) nuk përmbajnë konstatime apo cilësime juridike;¹⁵ (vii) nuk bazohen në marrëveshje midis palëve në çështjen *Mustafa*;¹⁶ (viii) nuk janë në proces apeli;¹⁷ dhe (ix) do të

⁵ F02390, Trupi Gjyqësor, *Vendim mbi Kërkesën e Përbashkët të Mbrojtjes për Zgjatje të Afatit të Dorëzimit të Përgjigjes ndaj Mocionit të Dytë të Prokurorisë për Konstatim Gjyqësor të Fakteve të Shqyrtuara në Procese të Tjera* (F02365), 19 qershor 2024.

⁶ F02419, Mbrojtësi i Specializuar, *Përgjigje e Përbashkët e Mbrojtjes ndaj Mocionit të Dytë të Prokurorisë për Konstatim Gjyqësor të Fakteve të Shqyrtuara në Procese të Tjera*, 1 korrik 2024, konfidenciale, me Shtojcën 1, konfidenciale (versionet e redaktuara publike të Përgjigjes dhe Shtojcës 1 të Përgjigjes u dorëzuan më 4 korrik 2024, F02419/RED dhe F02419/A01/RED).

⁷ F02434, Prokurorja e Specializuar, *Kundërpërgjigje e Prokurorisë ndaj Përgjigjes së Përbashkët të Mbrojtjes dhënë ndaj Mocionit të Dytë të Prokurorisë për Konstatim Gjyqësor të Fakteve të Shqyrtuara në Procese të Tjera*, 8 korrik 2024, konfidenciale (versioni i redaktuar publik u dorëzua po të njëjtën ditë, F02434/RED).

⁸ Shtojca 1 e Mocionit.

⁹ Mocioni, para. 1, 21.

¹⁰ Mocioni, para. 3, 5-6.

¹¹ Mocioni, para. 3, 7-8.

¹² Mocioni, para. 3, 9.

¹³ Mocioni, para. 3, 10-11.

¹⁴ Mocioni, para. 3, 12.

¹⁵ Mocioni, para. 3, 13.

¹⁶ Mocioni, para. 3, 14.

¹⁷ Mocioni, para. 3, 15-16.

mundësojnë kryerjen e drejtë dhe të shpejtë të procesit dhe rritjen e efikasitetit gjyqësor.¹⁸

8. Mbrojtja kundërshton pranimin e fakteve të shqyrtuara të mëtejshme dhe hedh poshtë sugjerimin se pranimi i tyre do të rrisë efikasitetin gjyqësor ose shpejtësinë e kryerjes së procesit.¹⁹ Mbrojtja përgjigjet se Trupi Gjykses duhet ta rrëzojë Mocionin si të parakohshëm, duke pasur parasysh kërkesën në proces shqyrtimi për mbrojtje të ligjshmërisë në çështjen *Mustafa*.²⁰ Si alternativë, Mbrojtja parashtron se Trupi Gjykses duhet t'i kërkojë ZPS-së të evidentojë, për secilin fakt të shqyrtuar, se cilin dëshmitar apo cilët dëshmitarë nuk do të thërrasë në qoftë se pranohet një fakt i caktuar i shqyrtuar. Mbrojtja parashtron se, në qoftë se kjo nuk bëhet, faktet e shqyrtuara e të propozuara, nuk duhet të pranohen për hir të efikasitetit të procesit.²¹ Gjithashtu, Mbrojtja kundërshton pranimin e këtyre kategorive të fakteve ("kundërshtimet ndaj kategorive"):

- (i) fakte që kanë të bëjnë me veprimet dhe sjelljen e të akuzuarve;²²
- (ii) fakte bazë të kundërshtuara që kanë të bëjnë me sjelljen e pretenduar të vartësve në lidhje me incidentet që ndikojnë drejtpërdrejt në përgjegjësinë penale të të akuzuarve ("kundërshtimet ndaj kategorisë C2");²³
- (iii) fakte që nuk citojnë burime të evidentuara qartë të provave ("kundërshtimet ndaj kategorisë C3");²⁴
- (iv) fakte të bazuara në prova që janë ose anonime ose të panxjerra në këtë çështje ("kundërshtimet ndaj kategorisë C4");²⁵

¹⁸ Mocioni, para. 1, 3, 17-19.

¹⁹ Përgjigja, para. 6, 17-23, 25, 29-30.

²⁰ Përgjigja, para. 15-16, 30.

²¹ Përgjigja, para. 6, 24.

²² Përgjigja, para. 26 C1. Trupi Gjykses thekson se Shtojca 1 e Përgjigjes nuk përmban kundërshtim për faktet e kategorisë "C1", shih para. 17 më poshtë.

²³ Përgjigja, para. 26 C2. Shih gjithashtu Shtojcën 1 të Përgjigjes.

²⁴ Përgjigja, para. 26 C3. Shih gjithashtu Shtojcën 1 të Përgjigjes.

²⁵ Përgjigja, para. 26 C4. Shih gjithashtu Shtojcën 1 të Përgjigjes.

- (v) fakte të bazuara në deklaratatë të dyshuarve që nuk kanë dëshmuar asnjëherë, në deklaratatë të bashkakuzuarve, ose të dëshmitarëve të cilët nuk mund të detyrohen të dëshmojnë, siç janë dëshmitarët e vdekur;²⁶
- (vi) fakte, ku gjuha e përdorur është tepër e mjegullt/e paqartë për t'u mbështetur në to, ku nuk përmenden provat në të cilat janë bazuar, apo ku ato janë "përzgjedhur" nga konteksti burimor në një mënyrë që mjegullon ose shtrembëron konstatimet origjinale ("kundërshtimet ndaj kategorisë C6");²⁷
- (vii) fakte që përbëjnë përshkrime të provave e jo konstatime konkrete ("kundërshtimet ndaj kategorisë C7");²⁸
- (viii) fakte që përmbajnë cilësime juridike në lidhje me konstatimet faktike përfundimtare ("kundërshtimet ndaj kategorisë C8");²⁹
- (ix) fakte që nuk janë kundërshtuar në procesin e parë, ose që janë marrë nga aktgjykime të cilat nuk janë apeluar ("kundërshtimet ndaj kategorisë C9");³⁰ dhe
- (x) fakte të bazuara në prova ose dëshmi të dëshmitarëve, të cilat ZPS-ja synon t'i paraqesë në këtë çështje ("kundërshtimet ndaj kategorisë C10").³¹

9. ZPS-ja kundërpërgjigjet se faktet e shqyrtuara e e të propozuara përmbushin të gjitha kriteret dhe, rrjedhimisht, janë të përshtatshme për konstatim gjyqësor.³² ZPS-ja hedh poshtë parashtrimet e Mbrojtjes se konstatimi i fakteve të shqyrtuara nuk ka sjellë reduktim të listave të dëshmitarëve apo të provave materiale të ZPS-

²⁶ Përgjigjja, para. 26 C5. Trupi Gjyqësor thekson se Shtojca 1 e Përgjigjes nuk përmban kundërshtim për faktet e kategorisë "C5", shih para. 17 më poshtë.

²⁷ Përgjigjja, para. 26 C6. Shih gjithashtu Shtojcën 1 të Përgjigjes.

²⁸ Përgjigjja, para. 26 C7. Shih gjithashtu Shtojcën 1 të Përgjigjes.

²⁹ Përgjigjja, para. 26 C8. Shih gjithashtu Shtojcën 1 të Përgjigjes.

³⁰ Përgjigjja, para. 26 C9, 27-28. Shih gjithashtu Shtojcën 1 të Përgjigjes.

³¹ Përgjigjja, para. 26 C10. Shih gjithashtu Shtojcën 1 të Përgjigjes.

³² Kundërpërgjigjja, para. 1, 6, 8.

së.³³ Ajo parashtron se faktet e shqyrtuara , për të cilat është bërë konstatim gjyqësor i kanë shërbyer dhe do të vazhdojnë t'i shërbejnë efikasitetit gjyqësor në këtë çështje.³⁴ ZPS-ja parashtron se, në qoftë se Mocioni miratohet, ajo do të mund të heqë katër dëshmitarë nga lista e dëshmitarëve të saj dhe të paraqesë për pranimit provat e një dëshmitari sipas rregullës 153 (që më parë do bëhej sipas rregullës 154).³⁵ ZPS-ja parashtron se konstatimi gjyqësor i fakteve të shqyrtuara e të propozuara, do t'u shërbente qëllimeve të rregullës 157(2).³⁶ Në lidhje me kundërshtimet ndaj kategorive, ZPS-ja kundërpërgjigjet se ato: (i) keqinterpretojnë faktet e shqyrtuara e të propozuara, Aktgjykimin *Mustafa*, kriteret dhe jurisprudencën e zbatueshme;³⁷ dhe (ii) tashmë janë shqyrtuar dhe rrëzuar nga Trupi Gjyqësor në Vendimin e Parë mbi Mocionin e Prokurorisë në lidhje me Faktet e Shqyrtuara.³⁸ Së fundi, ZPS-ja rithekson se Trupi Gjyqësor duhet ta miratojë Mocionin.³⁹

III. DISPOZITAT LIGJORE PËRKATËSE

10. Trupi Gjyqësor përfshin përmes referimit dispozitat ligjore përkatëse dhe aspektet e përgjithshme të përcaktuara në vendimet e mëparshme të tij.⁴⁰

IV. DISKUTIM

A. PARAKOHSHMËRIA E MOCIONIT

11. ZPS-ja parashtron se konstatimet faktike në Aktgjykimin *Mustafa* janë

³³ Kundërpërgjigjja, para. 2.

³⁴ Kundërpërgjigjja, para. 2, 4.

³⁵ Kundërpërgjigjja, para. 3.

³⁶ Kundërpërgjigjja, para. 2-5.

³⁷ Kundërpërgjigjja, para. 6.

³⁸ Kundërpërgjigjja, para. 6.

³⁹ Kundërpërgjigjja, para. 8.

⁴⁰ Vendimi mbi Mocionin e Prokurorisë në lidhje me Faktet e Shqyrtuara, para. 10-13, 17-18; Vendimi mbi Mocionin e Mbrojtjes në lidhje me Faktet e Shqyrtuara, para. 13-16, *shih gjithashtu* para. 39-43.

përfundimtare dhe të plota për konstatim gjyqësor sipas rregullës 157(2).⁴¹ ZPS-ja argumenton se kërkesat për mjete juridike të jashtëzakonshme, siç është kërkesa e Mbrojtjes së Mustafës për mbrojtje të ligjshmërisë që është në proces shqyrtimi (“Kërkesa për Mbrojtje të Ligjshmërisë”),⁴² pasojnë aktgjykimet “e formës së prerë”.⁴³ Sipas ZPS-së, nga kjo rrjedh se Kërkesa për Mbrojtje të Ligjshmërisë që është në proces shqyrtimi, nuk cenon kompetencën e Trupit Gjyqësor sipas rregullës 157(2).⁴⁴

12. Mbrojtja përgjigjet se, duke qenë se një prej mjeteve juridike të kërkuara në Kërkesën për Mbrojtje të Ligjshmërisë, është kthimi për rigjykim i çështjes gjyqësore,⁴⁵ faktet e shqyrtuara e të propozuara, nuk janë përfundimtare, por objekt shqyrtimi në proces. Sipas Mbrojtjes, nga kjo rrjedh se Trupi Gjyqësor nuk mund të bëjë konstatim gjyqësor të fakteve të shqyrtuara e të propozuara.⁴⁶

13. Trupi Gjyqësor vëren se, pasi palët dorëzuan parashtrimet e tyre, Dhoma e Gjykatës Kushtetuese dha vendimin në lidhje me Kërkesën për Mbrojtje të Ligjshmërisë.⁴⁷ Dhoma e Gjykatës Kushtetuese: (i) miratoi pjesërisht Kërkesën për Mbrojtje të Ligjshmërisë; (ii) anuloi pjesën e Aktgjyimit të Apelit në çështjen *Mustafa* “që ka të bëjë me dënimin e z. Mustafa”; dhe (iii) ia ktheu Aktgjykimin e Apelit në çështjen *Mustafa* Panelit të Apelit “për të marrë një vendim të ri dënimi për z. Mustafa në bazë të rregullës 194(1)(b)”.⁴⁸

14. Trupi Gjyqësor gjithashtu vëren se, në bazë të rregullës 193 dhe nenit 48(6) të Ligjit, “një palë mund të kërkojë mbrojtjen e ligjshmërisë brenda 3 (tre) muajsh nga

⁴¹ Mocioni, para. 15.

⁴² KSC-SC-2024-02, F00011, Mbrojtësi i Specializuar, *Kërkesë e Mbrojtjes për Mbrojtje të Ligjshmërisë me Shtojcat Konfidenciale 1 dhe 2, sipas nenit 48 (6) deri (8) të Ligjit dhe rregullës 193 të Rregullores*, 14 mars 2024.

⁴³ Mocioni, para. 16.

⁴⁴ Mocioni, para. 16.

⁴⁵ Kërkesa për Mbrojtjen e Ligjshmërisë, para. 117(ii).

⁴⁶ Përgjigja, para. 2.

⁴⁷ KSC-SC-2024-02, F00018, Dhoma e Gjykatës Kushtetuese, *Vendim mbi Kërkesën e Salih Mustafës për Mbrojtje të Ligjshmërisë* (“Vendimi mbi Kërkesën për Mbrojtje të Ligjshmërisë”), 29 korrik 2024.

⁴⁸ Vendimi mbi Kërkesën për Mbrojtje të Ligjshmërisë, para. 112.

[...] aktgjykimi i formës së prerë kundrejt të cilit kërkohet mbrojtje e ligjshmërisë". Trupi Gjykses rikujton se Paneli i Gjykatës së Apelit shpalli Aktgjykimin e Apelit në çështjen *Mustafa* më 14 dhjetor 2023.⁴⁹ Në të, Paneli i Gjykatës së Apelit rrëzoi të gjitha nënpikat e apelit në të cilat kundërshtoheshin konstatimet e bëra nga Trupi Gjykses në Aktgjykimin e çështjes *Mustafa*.⁵⁰

15. Trupi Gjykses vëren se kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë *nuk* mund të paraqitet mbi bazën e një përcaktimi të gabuar lidhur me faktet e çështjes.⁵¹ Së fundi, Trupi Gjykses thekson se Dhoma e Gjykatës Supreme e ktheu Aktgjykimin e Apelit në çështjen *Mustafa* vetëm për të marrë një vendim të ri dënimi për z. Mustafa.⁵² Nga kjo rrjedh se faktet e shqyrtuara e të propozuara të cilat burojnë nga Aktgjykimi në çështjen *Mustafa*, janë nga "procese të përfunduara" dhe nuk janë "në proces apeli".

16. Rrjedhimisht, Trupi Gjykses gjykon se Mocioni nuk është i parakohshëm. Trupi Gjykses rrëzon argumentin e Mbrojtjes për të kundërtën.

B. VLERËSIMI I FAKTEVE TË SHQYRTUARA E TË PROPOZUARA

17. Trupi Gjykses do të fillojë me trajtimin e kundërshtimeve të Mbrojtje ndaj kategorive të fakteve. Fillimisht, Trupi Gjykses vëren se ndonëse Mbrojtja rendit dhjetë kategori faktesh për të cilat ka kundërshtime, Shtojca 1 e Përgjigjes nuk përmban kundërshtim të evidentueshëm ndaj kategorisë C1 ose C5. Rrjedhimisht, Trupi Gjykses nuk do t'i trajtojë këto kundërshtime.

18. Në lidhje me kundërshtimet ndaj kategorisë C2,⁵³ Trupi Gjykses rikujton se

⁴⁹ *Shih më lart* para. 2, poshtëshënimin 2.

⁵⁰ Aktgjykimi i Apelit *Mustafa*, para. 483-484.

⁵¹ Rregulla 193(3).

⁵² Vendimi mbi Kërkesën për Mbrojtje të Ligjshmërisë, para. 112(e).

⁵³ Përgjigja, para. 26 C2; Shtojca 1 e Përgjigjes, Kundërshtimet për faktet e kategorisë C2: "fakte bazë të kundërshtuara që kanë të bëjnë me sjelljen e pretenduar të vartësve në lidhje me incidentet që ndikojnë drejtpërdrejt në përgjegjësinë e të akuzuarve".

ndalimi kategorik i konstatimeve gjyqësore mbi faktet që kanë lidhje me veprimet dhe sjelljet e të akuzuarve nuk përfshin, për shembull, veprimet dhe sjelljen e kryesve fizikë të krimeve ose ekzistencën dhe aktivitetin e ndërmarrjes kriminale të përbashkët ose të anëtarëve të saj, veç të akuzuarve.⁵⁴ Konkretisht, faktet që nuk lidhen drejtpërdrejt apo tërthorazi me përgjegjësinë penale të të akuzuarve, në thelb, nuk janë relevante për pika që kontestohen në këtë proces. Nga kjo rrjedh se konstatimi gjyqësor sipas rregullës 157(2) bëhet vetëm për fakte të shqyrtuara të cilat “kanë lidhje, të paktën në një farë mënyre, me përgjegjësinë penale të të akuzuarit”.⁵⁵ Trupi Gjyqësor është bindur se të gjitha faktet e shqyrtuara e të propozuara që kundërshtohen si fakte të kategorisë C2, janë paraqitur në lidhje me z. Salih Mustafa dhe/ose vartësit e tij, dhe jo në lidhje me ndonjë prej të akuzuarve në këtë çështje gjyqësore. Rrjedhimisht, Trupi Gjyqësor rrëzon kundërshtimet ndaj kategorisë C2.

19. Në lidhje me kundërshtimet ndaj kategorisë C3,⁵⁶ Trupi Gjyqësor rikujton se mungesa e citimeve tekstuale të provave mbështetëse, nuk e ndalon Trupin Gjyqësor të bëjë konstatim gjyqësor të fakteve të shqyrtuara, me kusht që ato të përmbushin kriteret për konstatim gjyqësor.⁵⁷ Sidoqoftë, Trupi Gjyqësor vëren se, kur lexohet në kontekstin e Aktgjykimit *Mustafa*, baza për faktet e shqyrtuara e të propozuara që kundërshtohen nga Mbrojtja është e qartë pasi ato: (i) janë ose të mbështetura drejtpërdrejt në prova ose në referenca brenda provave;⁵⁸ (ii) përkojnë

⁵⁴ Vendimi mbi Mocionin e Prokurorisë në lidhje me Faktet e Shqyrtuara, para. 24. *Shih gjithashtu* ICTR, *Prosecutor v. Karemera*, ICTR-98-44-AR73(C), Appeals Chamber, [Decision on Prosecutor's Interlocutory Appeal of Decision on Judicial Notice](#) (“Karemera Decision”), 16 June 2006, paras 48-53; ICTY, *Prosecutor v. Popović et al.*, IT-05-88-T, Trial Chamber II, [Decision on Prosecution Motion for Judicial Notice of Adjudicated Facts](#) with Annex, 26 September 2006, para. 13; *Prosecutor v. Mladić*, IT-09-92, Appeals Chamber, [Decision on Ratko Mladić's Appeal Against the Trial Chamber's Decisions on the Prosecution Motion for Judicial Notice of Adjudicated Facts](#), 12 November 2013, paras 82-87.

⁵⁵ [Karemera Decision](#), para. 45.

⁵⁶ Përgjigja, para. 26 C3; Shtojca 1 e Përgjigjes, kundërshtimet për faktet e kategorisë C3: “fakte që nuk citojnë burime të identifikuar qartë të provave”.

⁵⁷ ICTY, Trial Chamber I, *Prosecutor v. Ratko Mladić*, IT-09-92-PT, Trial Chamber I, [First Decision on Prosecution Motion for Judicial Notice of Adjudicated Facts](#), 28 February 2012, para. 25.

⁵⁸ *Shih p.sh.* Faktin e shqyrtuar e propozuar 41 që i referohet paragrafit 423 të Aktgjykimit *Mustafa*, ku poshtëshënimi 861 i referohet paragrafëve që mbështeten me prova.

me konstatimet e Trupit Gjykses të bëra mbi bazën e një analize tërësore të provave;⁵⁹ ose (iii) ndjekin një arsyetim të hollësishëm të Trupit Gjykses I.⁶⁰ Rrjedhimisht, Trupi Gjykses rrëzon kundërshtimet ndaj kategorisë C3.

20. Në lidhje me kundërshtimet ndaj kategorisë C4,⁶¹ Trupi Gjykses thekson se këto kundërshtime kanë të bëjnë me dy fakte të shqyrtuara e të propozuara.⁶² Trupi Gjykses vëren se burimet e këtyre dy fakteve të shqyrtuara e të propozuara për të cilat Mbrojtja ka kundërshtime, janë redaktuar në versionin publik të Aktgjykimit *Mustafa*, por nuk janë redaktuar në versionin konfidencial të tij.⁶³ Trupi Gjykses rikujton se, në vijim të vendimit të Trupit Gjykses, Mbrojtja ka qasje në versionin e paredaktuar konfidencial të Aktgjykimit *Mustafa*.⁶⁴ Rrjedhimisht, Trupi Gjykses gjykon se kundërshtimet e Mbrojtjes në lidhje me këtë pikë janë të pathemelta.

21. Në lidhje me kundërshtimet ndaj kategorisë C6,⁶⁵ Trupi Gjykses rikujton se të gjitha faktet e shqyrtuara e të propozuara burojnë nga çështja *Mustafa*. Trupi Gjykses vlerësoi qartësinë dhe konkretësinë e fakteve të shqyrtuara të propozuara brenda kontekstit gjeografik, kohor dhe lëndor të fushëveprimit të akuzave të çështjes *Mustafa* – konkretisht, ndalimit arbitrar, trajtimit mizor dhe torturimit së paku të gjashtë personave në kompleksin e ndalimit në Zllash, Kosovë, afërsisht

⁵⁹ *Shih p.sh.* Faktin e shqyrtuar e propozuar 27 që i referohet paragrafit 715 të Aktgjykimit *Mustafa*: “Trupi Gjykses konstaton se [...]”. *Shih gjithashtu* Faktet e shqyrtuara dhe propozuara 30-31 që u referohen paragrafëve 252, 332 të Aktgjykimit *Mustafa*: “Trupi Gjykses nuk gjen arsye për të vënë në dyshim thelbin e dëshmisë së të akuzuarit [...]”; Fakti i shqyrtuar e propozuar 34 që i referohet paragrafit 500 të Aktgjykimit *Mustafa*: “Trupi Gjykses ka konstatuar se [...]”. “Trupi Gjykses konstaton se i vetmi përfundim i arsyeshëm, bazuar në tërësinë e provave, është se [...]”.

⁶⁰ *Shih p.sh.* Faktin e shqyrtuar e propozuar 43 që i referohet paragrafit 454 të Aktgjykimit *Mustafa*.

⁶¹ Përgjigjja, para. 26 C4; Shtojca 1 e Përgjigjes, kundërshtimet për faktet e kategorisë C4 “fakte të bazuara në prova që janë ose anonime ose të panxjerra në këtë çështje”.

⁶² Faktet e shqyrtuara dhe propozuara 46-47.

⁶³ *Shih* Aktgjykimin *Mustafa*, poshtëshënimet 1367, 1411 (krahaso versionin e redaktuar publik me versionin e redaktuar konfidencial).

⁶⁴ F02276, Trupi Gjykses, *Vendim mbi Kërkesën e Prokurorisë për Qasje në Versionin Konfidencial të Aktgjykimit të Çështjes KSC-BC-2020-05*, 30 prill 2024.

⁶⁵ Përgjigjja, para. 26 C6; Shtojca 1 e Përgjigjes, kundërshtimet për faktet e kategorisë C6 “fakte, ku gjuha e përdorur është tepër e mjegullt/e paqartë për t’u mbështetur në to, ku nuk përmenden provat në të cilat janë bazuar, apo ku ato janë ‘përzgjedhur’ nga konteksti burimor në një mënyrë që mjegullon ose shtrembëron konstatimet origjinale”.

midis 1 prillit 1999 dhe 19 prillit 1999, dhe vrasjes së paligjshme të një personi të përmendur me emër, afërsisht midis 19 prillit 1999 dhe fundit të prillit 1999.⁶⁶ Duke pasur parasysh këtë, Trupi Gjykses gjykon se faktet e shqyrtuara e të propozuara, janë të dallueshme, konkrete, të evidentueshme dhe përfaqësojnë saktësisht konstatimin origjinal. Trupi Gjykses rrëzon kundërshtimet ndaj kategorisë C6.

22. Në lidhje me kundërshtimet ndaj kategorisë C7,⁶⁷ Trupi Gjykses gjykon se fakti i shqyrtuar i propozuar 100, si dhe fjalia e fundit e faktit të shqyrtuar e të propozuar 106,⁶⁸ në vetvete, përbëjnë më shumë përshkrime të provave se sa konstatime konkrete. Rrjedhimisht, Trupi Gjykses ushtron diskrecionin e vet dhe refuzon faktin e shqyrtuar e të propozuar 100 dhe fjalinë e fundit të faktit të shqyrtuar e të propozuar 106. Trupi Gjykses është bindur se faktet e tjera të shqyrtuara të propozuara, përbëjnë konstatime faktike. Rrjedhimisht, Trupi Gjykses rrëzon kundërshtimet e mbetura ndaj kategorisë C7.

23. Në lidhje me kundërshtimet ndaj kategorisë C8,⁶⁹ Trupi Gjykses rikujton se për të përcaktuar nëse një fakt i propozuar është konstatim faktik, Trupi Gjykses duhet të përcaktojë, përmes një vlerësimi rast pas rasti, nëse fakti i propozuar përmban konstatime ose cilësime që “në thelb janë juridike”.⁷⁰ Së pari, në lidhje me faktin e shqyrtuar e të propozuar 84, Trupi Gjykses vëren se termi “viktimë e vrasjes së paligjshme” është përkufizuar në Aktgjykimin *Mustafa* dhe i referohet një personi konkret.⁷¹ Trupi Gjykses rrëzon sugjerimin e Mbrojtjes se ai përbën cilësim juridik.⁷² Së dyti, Trupi Gjykses vëren se, me përjashtim të fakteve të shqyrtuara e të propozuara 37, 63 dhe 75, faktet e tjera të shqyrtuara e të

⁶⁶ *Shih* Aktgjykimin *Mustafa*, para. 24.

⁶⁷ Përgjigjja, para. 26 C7; Shtojca 1 e Përgjigjes, kundërshtimet për faktet e kategorisë C7 “fakte që përbëjnë përshkrime të provave e jo konstatime konkrete”.

⁶⁸ “Salih Mustafa u tha anëtarëve të tjerë të BIA-s: “Lëshone tha, se paska fat, ta lemë këtë”.

⁶⁹ Përgjigjja, para. 26 C8; Shtojca 1 e Përgjigjes, kundërshtimet për faktet e kategorisë C8 “fakte që përmbajnë cilësime juridike në lidhje me konstatimet faktike përfundimtare”.

⁷⁰ Aktgjykimi i Apelit *Mustafa*, para. 61.

⁷¹ Aktgjykimi *Mustafa*, para. 24.

⁷² *Shih* Shtojcën 1 të Përgjigjes, kundërshtimi për faktin 84 të kategorisë C8.

propozuara që kundërshtohen si fakte të kategorisë C8, janë të përfshira në pjesën e konstatimeve faktike të Aktgjyqimit *Mustafa*.⁷³ Rrjedhimisht, Trupi Gjykses është bindur se këto fakte konsistojnë në konstatime që në thelb nuk janë juridike. Së fundi, pasi ka vlerësuar rast pas rasti faktet e tjera të mbetura të shqyrtuara e të propozuara që kundërshtohen nga Mbrojtja, Trupi Gjykses është bindur se termat në to janë përdorur në kuptim faktik dhe jo si cilësime juridike. Rrjedhimisht, Trupi Gjykses rrëzon kundërshtimet ndaj kategorisë C8.

24. Në lidhje me kundërshtimet ndaj kategorisë C9,⁷⁴ Trupi Gjykses vëren se katër faktet e shqyrtuara e të propozuara që kundërshtohen nga Mbrojtja për këtë arsye, mbështeten nga provat.⁷⁵ Pavarësisht nëse z. Salih Mustafa ka pasur interes për t'i kundërshtuar këto fakte, Trupi Gjykses është i mendimit se ato nuk bazohen në një marrëveshje midis palëve. Përkundrazi, këto katër fakte të shqyrtuara e të propozuara, janë konstatime të Trupit Gjykses I mbi bazën e provave të paraqitura gjatë gjyqimit në çështjen *Mustafa*. Rrjedhimisht, Trupi Gjykses rrëzon kundërshtimet ndaj kategorisë C9.

25. Në lidhje me kundërshtimet ndaj kategorisë C10,⁷⁶ Trupi Gjykses rikujton se nxjerrja e konstatimit gjyqësor të fakteve të shqyrtuara, vërteton prezumimin e bazuar mirë të saktësisë së këtyre fakteve, të cilat rrjedhimisht nuk ka nevojë të provohen përsëri në gjykim.⁷⁷ Sidoqoftë, kjo nuk e shmang detyrimin që ka ZPS-ja

⁷³ *Shih* Shtojcën 1 të Përgjigjes, kundërshtimet për faktet e kategorisë C8.

⁷⁴ Përgjigjja, para. 26 C9, 27-28. *Shih gjithashtu* Shtojcën 1 të Përgjigjes, kundërshtimet për faktet e kategorisë C9 “fakte që nuk janë kundërshtuar në procesin e parë, ose që janë marrë nga aktgjykime të cilat nuk janë apeluar”.

⁷⁵ *Shih* Aktgjykimin *Mustafa*, para. 334, poshtëshënimet 656 dhe 659; para. 339, poshtëshënimin 676; para. 342, poshtëshënimin 694. *Shih gjithashtu* Faktet 1, 3, 11, 20 të shqyrtuara në procesin tjetër që janë propozuar 1, 3, 11, 20.

⁷⁶ Përgjigjja, para. 26 C10; Shtojca 1 e Përgjigjes, kundërshtimet për faktet e kategorisë C10 “fakte të bazuara në prova ose dëshmi të dëshmitarëve, të cilat ZPS-ja synon t'i paraqesë në këtë çështje”.

⁷⁷ *Shih p.sh.* ICTY, *Prosecutor v. Perišić*, IT-04-81-PT, Trial Chamber I, [Decision on Prosecution's Motion for Judicial Notice of Facts Relevant to the Srebrenica Crime Base](#), 22 September 2008, para. 21; *Prosecutor v. Popović et al.*, IT-05-88-A, Appeals Chamber, [Judgement](#), 30 January 2015, para. 620; *Prosecutor v. Stanišić and Župljanin*, IT-08-91-T, Trial Chamber II, [Decision Granting in Part Prosecution's Motions for Judicial Notice of Adjudicated Facts Pursuant to Rule 94\(B\)](#), 1 April 2010, para. 25.

për të provuar jashtë dyshimit të arsyeshëm faktet materiale që janë relevante për provat dhe argumentet e saj. Në varësi të nevojës për të shmangur përsëritjet e panevojshme të provave dhe për të siguruar që procesi të mos zgjatet më tepër se sa duhet, është me rëndësi që Trupit Gjykses t'i jepen prova për të gjitha faktet relevante për këtë çështje gjyqësore, veçanërisht në lidhje me faktet për të cilat ka kundërshtime mes palëve. Për këtë arsye, me kusht që të jenë përmbushur kritere të tjera, Trupi Gjykses nuk është bindur se rrethana se disa fakte bazohen në prova ose dëshmi të dëshmitarëve të cilët ZPS-ja synon t'i paraqesë në procesin aktual, ndalon konstatimin gjyqësor të këtyre fakteve. Trupi Gjykses gjithashtu rikujton se konstatimi gjyqësor i fakteve të shqyrtuara nuk ndikon në aftësinë dhe të drejtën e Mbrojtjes për të kundërshtuar çfarëdo pretendimi faktik që është pjesë e provave dhe argumenteve të Prokurorisë apo çfarëdo fakti për të cilin është bërë konstatim gjyqësor nga Trupi Gjykses.⁷⁸ Në fakt, Mbrojtja do të ketë mundësinë të kundërshtojë në gjykim saktësinë e fakteve për të cilat ka kundërshtime.⁷⁹ Trupi Gjykses vëren se, në qoftë se dëshmitarët dëshmojnë ashtu siç synohet aktualisht nga ZPS-ja, Mbrojtja do të ketë mundësinë t'u bëjë pyetje si palë jothirrëse dëshmitarëve që do të dëshmojnë në lidhje me faktet dhe rrethanat që janë objekt i Mocionit në fjalë, dhe për të cilat Mbrojtja ka paraqitur kundërshtimet e saj sipas kategorisë përkatëse C10.⁸⁰ Në lidhje me faktet e shqyrtuara e të propozuara 1-3, 9-13, 15-16, 20 dhe 29, për të cilat Mbrojtja argumenton se mbështeten në dëshminë e W04746-ës, Trupi Gjykses vëren se W04746 nuk dëshmoi në gjykimin e çështjes *Mustafa*. Trupi Gjykses gjithashtu vëren se baza e fakteve të shqyrtuara të propozuara që kundërshtohen nga Mbrojtja, nuk është W04746 por z. Salih

⁷⁸ Vendimi mbi Mocionin e Prokurorisë në lidhje me Faktet e Shqyrtuara, para. 26.

⁷⁹ Vendimi mbi Mocionin e Prokurorisë në lidhje me Faktet e Shqyrtuara, para. 13.

⁸⁰ Për shembull, Mbrojtja do të ketë mundësinë të marrë në pyetje si palë jothirrëse W04484-ën dhe W04485-ën në lidhje me faktin e shqyrtuar dhe propozuar 21; W04485-ën dhe W04600 në lidhje me faktin e shqyrtuar dhe propozuar 22; W04600-ën dhe W04485-ën në lidhje me faktin e shqyrtuar dhe propozuar 29; W03593-shin në lidhje me faktet e shqyrtuara dhe propozuara 38, 46, 64, 84, 100-108, 135-136; dhe të gjitha faktet e shqyrtuara e të propozuara që kanë lidhje me provat e W01679-ës, në qoftë se provat e W01679-ës nuk paraqiten për praninë sipas rregullës 153.

Mustafa. Rrjedhimisht, Trupi Gjykses rrezon kundërshtimet ndaj kategorisë C10.

26. Krahas shqyrtimit individual të secilit kundërshtim të Mbrojtjes për faktet sipas kategorive, Trupi Gjykses kreu një analizë të individualizuar, fakt për fakt, të të gjitha fakteve të shqyrtuara e të propozuara. Kur fakti i propozuar përmbante disa fjali dhe/ose sugjerime faktike, Trupi Gjykses mori në shqyrtim secilin prej tyre. Trupi Gjykses verifikoi nëse secili fakt i shqyrtuar e i propozuar, përmbushte kriteret e Rregullores dhe, kur këto kritere përmbusheshin, nëse, megjithatë, duke ushtruar diskrecionin e vet, Trupi Gjykses duhej të refuzonte konstatim gjyqësor.

27. Trupi Gjykses rikujton se nuk pranoi të bënte konstatim gjyqësor të faktit të shqyrtuar e të propozuar 100 dhe të fjalisë së fundit të faktit të shqyrtuar e të propozuar 106.⁸¹ Pasi shqyrtoi individualisht secilin prej fakteve të tjera të shqyrtuara të propozuara, Trupi Gjykses është bindur se të gjitha ato: (i) burojnë nga procese të tjera të Dhomave të Specializuara, konkretisht nga çështja gjyqësore *Mustafa*; (ii) kanë lidhje me pika që kontestohen në procesin aktual; dhe (iii) përmbushin kriteret e rregullës 157(2) pasi nuk kanë lidhje me veprimet dhe sjelljen e të akuzuarve që përmenden si akuza në aktakuzë. Sa i përket kësaj të fundit, Trupi Gjykses thekson se Mbrojtja nuk parashtron se ndonjë prej fakteve të shqyrtuara e të propozuara ka lidhje me veprimet dhe sjelljen e të akuzuarve.⁸²

28. Trupi Gjykses është gjithashtu i mendimit se faktet e shqyrtuara e të propozuara 1-42, 44-91, 93-99, 101-105, 106,⁸³ 108-162, 164-171: (i) janë të dallueshme, konkrete dhe të evidentueshme; (ii) nuk ndryshojnë në mënyrë thelbësore nga formulimi i Aktgjykimit origjinal; (iii) nuk janë të paqarta ose çorientuese në kontekstin në të cilin janë parashtruar në Mocionin e palës parashtruese; (iv) nuk përmbajnë konstatime apo cilësime juridike; (v) nuk bazohen në marrëveshje midis palëve në procesin origjinal; dhe (vi) nuk janë në

⁸¹ *Shih* para. 21-22 më lart.

⁸² Shtojca 1 e Përgjigjes nuk përmban kundërshtim për faktet e kategorisë C1. *Shih gjithashtu* para. 17 më lart.

⁸³ Përveç fjalisë së fundit, *shih* para. 22 më lart.

proces apeli apo rishikimi. Trupi Gjykues është i bindur se për këto fakte të shqyrtuara e të propozuara, duhet të bëhet konstatim gjyqësor.

29. Sidoqoftë, Trupi Gjykues konstaton se faktet e shqyrtuara e të propozuara 43, 92, 163 dhe 172 nuk do ta ndihmojnë Trupin Gjykues në përmbushjen e funksionit të tij të konstatimit të fakteve. Rrjedhimisht, Trupi Gjykues ushtron diskrecionin e tij dhe refuzon të bëjë konstatim gjyqësor të këtyre fakteve të shqyrtuara e të propozuara.

30. Së fundi, siç pasqyrohet në Shtojcën e këtij vendimi, Trupi Gjykues ka ushtruar diskrecionin e tij për të hequr, *proprio motu*, një fjalë nga fakti i shqyrtuar e i propozuar 159. Po kështu, Trupi Gjykues vëren se një pjesë e faktit të shqyrtuar e propozuar 165, thjesht përsërit një pjesë të faktit të shqyrtuar e propozuar 164. Për këtë arsye, Trupi Gjykues hoqi fjalët që përsëriteshin nga fakti i shqyrtuar e propozuar 165.

V. VENDIM

31. Për arsyet e lartpërmendura, Trupi Gjykues:

- a) **MIRATON**, pjesërisht, Mocionin;
- b) **BËN KONSTATIM GJYQËSOR** të fakteve në vijim të shqyrtuara e të propozuara që renditen në Shtojcën 1 të këtij vendimi: 1-42, 44-91, 93-99, 101-162 dhe 164-171; dhe
- c) **REFUZON** të bëjë konstatim gjyqësor të fakteve në vijim të shqyrtuara e të propozuara, ose të pjesëve të tyre: 43, 92, 100, 106 (fjalë e fundit), 163 dhe 172.

/nënshkrimi/

Gjykatës Çarls L. Smith, III

Kryegjykatës

E mërkurë, 21 gusht 2024

Në Hagë, Holandë.